

NJOFTIM

Drejtuar: Agjencise Kombetare te Mjedisit

Lenda: Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun

Shoqeria "ALBAVIA" Sh.p.k njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per ndryshim te kushteve te lejes se mjedisit te tipit B per instalimin:

Impiant prodhimi asfaltobetoni dhe emulsioni bituminoz, me vendndodhje Qarku Tirane, Bashkia Kamez, prane fshatit Çerkeze.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014 , Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” te ndryshuar, kreu VI “Informimi dhe pjesemarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B”, bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

- a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo **“Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”.**
- b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
- c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
- d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- e) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
- f) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
- g) Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
- h) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
- i) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit

Subjekti “ALBAVIA” Sh.p.k

NIPTI: J81527001Q

Adresa: Qarku Tirane, Bashkia Kamez, prane fshatit Çerkeze.

Administratori

Shkelqim Rakipaj

- a. Kërkesa për vendosjen në funksionim të instalimit “Impiant prodhimi asfaltbetoni dhe emulsi bituminoz” është për aplikim **per ndryshim te kushteve te lejes mjedisore te tipit B me PN-7952-09-2014**, sipas Shtojces 1, të Ligjit Nr. 52/2020, Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar”:
Veprimtarite e katranit dhe bitumit

ID 7.3. c. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi.

b. TE DHENAT E EKSTRAKTIT TE QKB-SE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË
DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	J81527001Q
2. Data e Regjistrimit	26/03/1998
3. Emri i Subjektit	ALBAVIA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	20/03/1998
6. Kohëzgjatja	Nga: 20/03/1998
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk. I, ap.19
8. Kapitali	135.450.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Kryerjen e aktivitetit në ndertimet civile, industriale, inrastruktura, ushtarake etj., si për llogari të vet ashtu dhe për të tretet, ku përfshihen ndertime pallatesh banimi, godina social-kulturore, komplekse industriale, ndertimet rrugore, hekurudha, porte, aeroporte, ura dhe vepra arti, centrale elektrike, linja të tensionit të lartë dhe të mesëm, ujesjellesa, kanalizime, impiante të pastrimit, sinjalistike rrugore, punime topo-gjeodezike etj; Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, llaçi, betoni, parafabrikatesh, materialesh asfaltike, materialesh të tjera të nevojshme në përgjithësi dhe për tregtimin e tyre për kryerjen e punimeve të ndertimit në përgjithësi si dhe tregtimin e tyre; Punime inxhinierike projektimi, duke përfshirë por pa u kufizuar në vepra urbane, arkitekture, punime ndertimi, instalimi, pune hidraulike, punime rrugore dhe hekurudhore, ura dhe vepra arti, inxhinieri topografike dhe hidrologjike, inxhinieri,

c. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

Emri i instalimit/impianitit ¹	Veprimtarite e katranit dhe bitumit																		
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	Qarku Tirane, Bashkia Kamez, prane fshatit Çerkeze.																		
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4 	<table border="1" data-bbox="869 543 1398 829"> <thead> <tr> <th colspan="3">Koordinatat e objektit ne sistemin Gaus-Kruger te gjeneruara ne portalin asig.gov.al</th> </tr> <tr> <th>Nr.</th> <th>Koordinatat Y</th> <th>Koordinatat X</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>4397945.28</td> <td>4584742.72</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>4397907.92</td> <td>4584697.96</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>4397991.75</td> <td>4584617.14</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>4398023.19</td> <td>4584652.53</td> </tr> </tbody> </table>	Koordinatat e objektit ne sistemin Gaus-Kruger te gjeneruara ne portalin asig.gov.al			Nr.	Koordinatat Y	Koordinatat X	1	4397945.28	4584742.72	2	4397907.92	4584697.96	3	4397991.75	4584617.14	4	4398023.19	4584652.53
Koordinatat e objektit ne sistemin Gaus-Kruger te gjeneruara ne portalin asig.gov.al																			
Nr.	Koordinatat Y	Koordinatat X																	
1	4397945.28	4584742.72																	
2	4397907.92	4584697.96																	
3	4397991.75	4584617.14																	
4	4398023.19	4584652.53																	
Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi ²	ID 7.3. pika c. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi.																		
Kapaciteti i projektuar	Kapaciteti maksimal i projektuar eshte 90 ton/ore asfalt. Kapaciteti i prodhimit te emulsionit bituminoz: 120000 litra/vit																		

¹ Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

² Shkruani kodet e specifikuar në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

Ortofoto e vendit ku do te ushtrohet aktiviteti



d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET

AKTIVITETI: Impiant prodhimi asfaltobetoni dhe emulsioni bituminoz.
Adresa: Qarku Tirane, Bashkia Kamez, prane fshatit Çerkeze.
Subjekti: "ALBAVIA" Sh.p.k
Administrator: Z. Shkelqim Rakipaj

- **Hyrje**

Profili i shoqërisë "ALBAVIA" Sh.p.k

Ushtrimi i aktivitetit per Impiantin e prodhimit te asfaltobetonit të shoqërisë "ALBAVIA" Sh.p.k është i vendosur ne Qarku Tirane, Bashkia Kamez, prane fshatit Çerkeze. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin ne fushen "Kryerjen e aktivitetit ne ndertimet civile, industriale, infrastrukture, ushtarake etj., si per llogari te vet ashtu dhe per te tretet, ku perfishihen ndertime pallatesh banimi, godina social-kulturore, komplekse industriale, ndertimet rrugore, hekurudha, porte, aeroporte, ura dhe vepra arti, centrale elektrike, linja te tensionit te larte dhe te mesem, ujesjellesa, kanalizime, impiante te pastrimit, sinjalistike rrugore, punime topo-gjeodezike etj; Shfrytezim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, llaçi, betoni, parafabrikatesh, materialesh asfaltike, materialesh te tjera te nevojshme ne pergjithesi dhe per tregtimin e tyre per kryerjen e punimeve te ndertimit ne pergjithesi si dhe tregtimin e tyre; Punime inxhinierike projektimi, duke perfshire, por pa u kufizuar ne vepra urbane, arkitekture, punime ndertimi, instalimi, pune hidraulike, punime rrugore dhe hekurudhore, ura dhe vepra arti, inxhinieri topografike dhe hidrologjike, inxhinieri, studime gjeologjike, pune inxhinierike te impianteve teprodhimit dhe transemtimit te energjise etj. Pjesemarrje ne tendera te te gjitha llojeve si dhe marrja persiper e projektevete ndertimit vetem ose ne bashkepunim me çdo person fizikose juridik nepermjet komisionit direkt per shtetin, organizatat publike ose private, dhe çdo organizate tjeter te sektorit publik duke perfshire dhe organet e qeverisjes vendore; Kryerjen e te gjitha veprimeve tregtare, industrial dhe financiare mbi pasuri te luajteshme dhe te paluajteshme, te quajtura nga administratoret te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te Shoqerise, etj. Punime civile per rikualifikim urban, Transport te mallrave brenda vendit me mjete jashte norme per llogari te vete.", me Nr NIPT: **J81527001Q**. Nga sa me siper subjekti kryen aktivitet edhe ne fushen e prodhimit te asfaltobetonit, aktivitet per te cilin subjekti ka aplikuar dhe eshte pajisur me leje mjedisore te tipit B me PN-7952-09-2014, date 11.09.2014.

Sa më sipër, për këtë aktivitet, për rritjen e cilësisë së prodhimit, subjekti ynë ka paraqitur interes për shtimin e kapacitetit të tij duke përfshirë në këtë aktivitet edhe impiantin e prodhimit të emulsionit bituminoz. Emulsioni bituminoz është përdorur për aplikim në shtrimin e rrugëve që në shekullin e kaluar dhe që atëherë dhe deri më sot, përdorimi i tij është rritur në termat e numrit të aplikimeve dhe markave të reja. Arsyeja e këtij sukseesi është se emulsioni bituminoz ka me shumë avantazhe se materialet e tjera si për shembull ulja e kostove, ulja e konsumimit të energjisë dhe ndotjes dhe praktikitet në përdorim.

Per kete arsye kërkojmë te kryejme ndryshim e kushteve te lejes ekzistuese te mjedisit me qellim qe ne te të shtohet edhe kapaciteti i prodhimit të emulsionit bituminoz. Theksojmë se për këtë aktivitet nuk kemi kryer zgjerim të sipërfaqes së aktivitetit, as ndryshim të vendodhjes së tij, por vetëm shtim të kapacitetit.

Foto te objektit ku do te zhvillohet aktiviteti



Mjetet e renda te transportit



Sheshi i parkimit te mjeteve te renda te transportit



Informacion mbi kompanine "ALBAVIA" Sh.p.k

Shoqeria "ALBAVIA" Sh.p.k është një shoqeri e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin në fushën "Kryerjen e aktivitetit në ndërtimet civile, industriale, infrastrukture, ushtarake etj., si për llogari të vet ashtu dhe për të tretet, ku përfshihen ndërtime pallatesh banimi, godina social-kulturore, komplekse industriale, ndërtimet rrugore, hekurudha, porte, aeroporte, ura dhe vepra arti, centrale elektrike, linja të tensionit të lartë dhe të mesëm, ujesjellesa, kanalizime, impiante të pastrimit, sinjalistike rrugore, punime topo-gjeodezike etj; Shfrytëzim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, llaçi, betoni, parafabrikatesh, materialesh asfaltike, materialesh të tjera të nevojshme në përgjithësi dhe për tregtimin e tyre për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përgjithësi si dhe tregtimin e tyre; Punime inxhinierike projektimi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në vepra urbane, arkitekture, punime ndërtimi, instalimi, pune hidraulike, punime rrugore dhe hekurudhore, ura dhe vepra arti, inxhinieri topografike dhe hidrologjike, inxhinieri, studime gjeologjike, pune inxhinierike të impianteve të prodhimit dhe transemitimit të energjisë etj. Pjesëmarrje në tendera të të gjitha llojeve si dhe marrja për sipër e projekteve të ndërtimit vetëm ose në bashkëpunim me çdo person fizik ose juridik nëpërmjet komisionit direkt për shtetin, organizatat publike ose private, dhe çdo organizatë tjetër të sektorit publik duke përfshirë dhe organet e qeverisjes vendore; Kryerjen e të gjitha veprimeve tregtare, industriale dhe financiare mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të quajtura nga administratoret të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë, etj. Punime civile për rikualifikim urban, Transport të mallrave brenda vendit me mjete jashtë norme për llogari të vetë". Qëllimi i firmës ka qenë dhe mbetet përbushja e kërkesave të cilësive dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësive në të gjitha hallkat e saj.

Për këtë qëllim, subjekti "ALBAVIA" Sh.p.k referuar Shtojcës 1 të Ligjit nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetër, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" të ndryshuar, Kreu V, Seksioni 1, Pika 2, ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për të kryer ndryshimin e kushteve të Lejes së Mjedisit të Tipit B për aktivitetin "Impiant prodhimi asfaltobetonit dhe emulsion bituminoz", me vendndodhje Qarku Tiranë, Bashkia Kamez, pranë fshatit Çerkeze. Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Vendosja e këtij instalimi në këtë zonë është e pershtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi është në distancë nga qendrat banuara dhe dendësia e objekteve të banimit nuk është e madhe, gjithashtu ndodhet në largësi nga objektet apo veprat hidroenergjetike, etj. Në zonën në studim nuk ka objekte banimi apo shtëpi të ndryshme.

Qëllimi i këtij aktiviteti është prodhimi i asfaltobetonit me të gjitha parametrat dhe cilësitë e kërkuara në treg për shtrimin e rrugëve. Asfaltobetonit i prodhuar dhe emulsion bituminoz do të përdoren si lende e parë në fushën e infrastruktures, për shtrimin e rrugëve, etj.

Procesi i punës për impiantin e prodhimit të asfaltobetonit konsiston si më poshtë:

Në bazë të lejes mjedisore, impianti i prodhimit të asfaltobetonit është instaluar në një shesh të shtruar me beton me një sipërfaqe prej 12 000m² dhe me një kapacitet prodhues 90 Ton/Ore asfalt. Megjithatë, gjatë periudhës kur ky impiant ka qenë në funksion, mund të themi që instalimi është teresisht i ri, prodhim i viteve të fundit, teknologji bashkëkohore dhe me nivelin e shkarkimeve brenda standartit EU të lejuar. Instalimi është i pajisur me filtra me thasë, të cilët kryejnë kapjen e pluhurit dhe e depozitojnë

ate ne canta te medha. Me pas ky pluhur mund te dergohet ne landfill per asgjesisim ose per t'u perfshire ne procese riciklimi sipas kerkeses se tregut per kete material.

Objektet ku instalohen keto impiante, ne pergjithesi jane te perbera nga keto element:

- Sheshi i depozitimit te inerteve
- Bunkeret me kater ndarje sipas fraksioneve te materialit inert
- Transportieri i inerteve
- Barabani i nxehjes se inerteve deri ne temperaturen 150°C
- Elevatori, i cili dergon inerteve ne perzieres
- Mikseri i perzierjes se inerteve me bitumin e lengshem ne temperaturen 150°C
- Transportieri i pjerret, i cili dergon prodhimin ne bunkerin e akumulimit
- Depozita e bitumit
- Depozita e solarit (lenda djegese)

Impianti i prodhimit te asfaltit, ka destinacion kryesor prodhimin e konglomerateve bituminoze per shtrimin e rrugeve. Konglomeratet bituminoze kane ngjyre te zeze, me arome karakteristike dhe gjendje fizike viskoze.

Proceset teknologjike per kete lloj aktiviteti ne pergjithesi jane:

- Ngrohja e pajisjeve apo sistemeve
- Tharja / ngrohja e inerteve
- Impianti i emulsionit
- Sistemi i ventilimit dhe aspirimit
- Sistemi i pluhur-kapjes
- Sistemi automatik i komandimit te impiantit

Procesi i punes per kete lloj aktiviteti ne pergjithesi konsiston si me poshte:

Impianti funksionon ne kete menyre: ne bunkerin e furnizimit te inerteve hidhen me buldozer inerte te fraksioneve te ndryshme sipas cilesise se kerkuar te asfaltit. Me pas nepermjet transportiereve i transportojne ato per ne mikserin e perzierjes me bitumin i cili mberrin aty ne trajte te lenget (ky i fundit ngrohur me pare nepermjet kaldajes). Pasi perzihen mire, nepermjet mikserit ne trajte shneku, transportohen per ne transportierin me kova, i cili e dergon asfaltin ne sillosen e furnizimit te kamioneve transportues per ne vendin e perdorimit te tij.

Skema e prodhimit te asfaltobetonit



Pershkrimi i punes per prodhimin e emulsionit bituminoz

Emulsioni bituminoz eshte perdorur per aplikim ne rruge qe ne shekullin e kaluar dhe qe ateher dhe deri me sot, perdorimi i tij eshte rritur ne termat e numrit te aplikimeve dhe markave te reja. Arsyeja e ketij suksesesi eshte se emulsioni bituminoz ka me shume avantazhe se materialet e tjera si pershembull ulja e kostove, ul konsumimin e energjise dhe ndotjes, praktikitet ne perdorim.

Ne pergjithesi, lidhur me teknologjine e adaptuar per prodhimin e emulsioneve bituminoze, dallojme dy tipe te hedhura ne treg: impiant me proces te nderprere (Batchplant) dhe proces te vazhdueshem. Bazuar ne njohurie e fituara gjate experiences tone, ne kemi adaptuar impiantin me proces te nderprere Batch Plant, si me fleksibel dhe lehtesisht te operueshem ne termat e tipit te emulsionit qe do te operohet. Impianti jone arrine kapacitetin ton/ore.

Formula e prodhimit sipas INTERCHIMICA Italy.

<u>EMULSIONI ACID</u>	<u>EMULSION BAZIK</u>
<ul style="list-style-type: none">• Bitumi- 55 %• Stabiloil per t'ja shtuar• Bitumit – 1.50 %• 1 Iter acid L 0.30 %• Acid klorhidrik HCL 33• grad B 0.25 %• Uji i formulimit deri ne 100 %	<ul style="list-style-type: none">• Bitumi- 50 %• Stabiloil- 1.50 %• Iterpich B plus per t'ja shtuar bitumit 1.50 %• Iteral AL 98-N 0.15 %• Sode kaustike NAOH 98 % -0.15 %• Uji i formulimit deri ne 100 %


Formula e prodhimit sipas ELSAMEX Spanje per 1000 kg (litra). Me te cilen prodhohet aktualisht.

<u>EMULSIONI ACID</u>	<u>EMULSION BAZIK</u>
	<ul style="list-style-type: none">• Bitumi- 500 kg• Vajguri 15 litra• Soda kaustike 1.5 kg• Uje 483.5 litra

PROCESI TEKNOLOGJIK

Procesi realizohet me impiant te prodhuar nga MASSENZA srl Italy.

Procesi teknologjik konsiston ne tretjen e bitumit te nxehte, ne perzierjen e ujit me aditivet Bitumi i nxehte ne temperature 140 grade celsius hidhet ne vaske me kapacitet 2000 l, Njekohesisht ne vasken tjetere hidhen aditiv, uje, sode kaustike dhe vajguri. Kjo perzierje ngrohet ne temperature 45 grade celsius. Te gjitha perberesit hidhen sipas receptures. Pas arritjes se temperaturave fillon procesi i bashkimit te perzierjes dhe bitumit nepermjet pompave ne sasi te kontrolluar, e cila kalon ne mulli del produkti i gatshem. Ky produkt kalon ne depoziten 6000 litra. Gjate ketij procesi nuk krijohen mbetje apo ndotje te ambientit. Procesi i nxehtjes behet me kaldaje fuqi 100 kW me gaz. Konsumi i gazit eshte mesatarisht 10 l/h.



- Te pergjithshme

Subjekti "ALBAVIA" Sh.p.k, si nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne fushen e prodhimeve infrastrukturore, ka marre te gjitha masat perkatese per marrjen e lejeve dhe licencave perkatese me qellim mirefunksionimin e aktivitetit te prodhimit te asfaltobetonit, gjithashtu per mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e minimizimin e ndotjes ose pakesimin e ndikimeve negative nga ky aktivitet, subjekti po pregatit dokumentacionin per aplikimin e ndryshimit te kushteve te lejes ekzistuese te mjedisit tipi B per aktivitetin e prodhimit te asfaltobetonit, duhe shtuar ne te edhe impiantin e prodhimit te emulsionit bituminoz me besimin se cilesia, prodhimi per klientet dhe teknologjia e avancuar do te çojne ne permiresim te vazhdueshem ne te gjitha zonat operationale te veprimtarise, duke ndermarre programe te menaxhimit te cilesise dhe mjedisit qe inkurajojne bashkepunim dhe komunikim, vendimarrje racionale, permiresojne eficencen operationale, identifikojne dhe menaxhojne riskun.

Gjate zhvillimit te veprimtarise do te:

- Integrojne ne vendimarrjet e subjekti, duke patur konsiderat ceshtjet dhe impaktet mjedisore
- Ndergjegjesoje ne menyre te vazhdueshme punonjesit e Shoqerise dhe kontraktoreve dhe do t'i inkurajoje per te punuar ne menyre miqesore me mjedisin.
- Trajnoje, edukoje dhe informoje punonjesit rreth ceshtjeve mjedisore qe do te ndikojne ne punen e tyre.
- Do te shmanget perdorimi i panevojshem i materialeve dhe produkteve te rrezikshme si dhe do te ndermerren te gjitha hapat e nevojshem per te mbrojtur shendetin dhe mjedisin ne rast se materiale te tilla do te perdoren ose depozitohen ne zonen ku zhvillohet veprimtaria.
- Hartohen dhe rifreskohet Plani i kunderveprimit ndaj ndotjeve me mbetjet nga aktiviteti, kur kerkohet nga legjislacioni, ose kur egzistojne rreziqe qe kercenojne shendetin dhe mjedisin.
- Komunikohet tek klientet dhe publiku angazhimi mjedisor, duke inkurajuar ata qe ta mbeshtesin ate.
- Fokusohen per permiresimin e vazhdueshem te performances mjedisore dhe do te minimizojne impaktet dhe demtimet sociale te aktiviteteve duke rishikuar politikat mjedisore ne lidhje me aktivitetet e se ardhmes.

Me hapesirat e krijuara në këtë aktivitet mundesohet nje levizje e mire e mjeteve teknologjike te aktivitetit, si dhe mjeteve te tjera, te cilat i sherbejne aktiviteti.

Ambienti eshte i shtruar me beton dhe pjeserisht çakull dhe i pajisur me rrjetin e drenazhimit te ujrave, duke shmangur mundesine e ndotjes se mjedisit nga levizja e mjeteve, si dhe reduktimin e shkarkimeve ne ajer nga te grimcave te pluhurit si rezultat i levizjes se mjeteve te transportit. Duke qene nje aktivitet ne fushen e prodhimit te betonit, ndikimi kryesor ne mjedis eshte shkarkimi i ujrave te perdorura, shkarkimet ne ajer dhe gjenerimi i zhurmave, te cilat po i pershkruajme si me poshte:

Shkarkime ne uje

Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera higjenosanitare te cilat shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Nga procesi i prodhimit te asfaltobetonit, nuk ka shkarkime te lengeta, pasi procesi teknologjik nuk perfshin ujin ne teresine e tij. Shkarkimet e vetme dhe shume te rendesishme jane vetem ato te gazta ne atmosfere.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer jane pika me e rendesishme e ndotjes dhe shkarkimeve ne mjedis te ketij aktiviteti. Ndotja me e madhe vjen nga aktiviteti i prodhimit te asfaltobetonit, i cili ka ne proces furre me lende djegese hidrokarbure (solar dhe gas). Per prodhimin e asfaltit, nevojitet qe bitumi te kete nje temperature qe varion 60-90°C, ne menyre qe te shnderrohet ne trajte te lengshme dhe te behet i

mundur transportimi i tij per ne mikser dhe ne furren e shkrirjes, ku arrin temperatura rreth 170-180°C. Per te arritur kete temperature, sistemi ka nje kaldaje e cila ne rastin ne vleresim, funksionon me lende djegese Naftë e perpunuar. Ndersa furra e tharjes se materialit dhe e miksimit te inerteve me bitumin funksionon me lende djegese gas, duke qene se kerkon nje energji dhe nje temperature me te larte ne furre. Emetimet ne ajer vijne vetem nga prodhimi i asfaltobetonit, ndersa prodhimi i emulsionit bituminoz nuk shoqerohet me emetime ne ajer.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe prodhohen ne kantier jane te ndryshme. Ato mund te shkaktohen nga mjetet e transportit te rende, nga mjetet e ngarkim-shkarkimit te materialit dhe procesit te impiantit te prodhimit te asfaltobetonit. Gjithashtu zhurma mund te shkaktohen edhe nga perdorimi i kompresoreve dhe i gjeneratorit ne rast te nderprerjes se energjise elektrike. Keto zhurma nuk jane te larta per punonjesit, megjithate, ne rast te shqetesimeve te mundshme, ata mund te perdorin kufje gjate punes.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe prodhohen jane ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, paletat, plastmasi, metalet, etj, jane 100% te riciklueshme dhe menaxhohen nga kompania qe mbulon kete sherbim ne zone. Mbetje e rendesishme ne kete proces teknologjik, eshte vetem pluhuri i kapur nga filtri, i cili ne pjesen me te madhe te tij rifutet ne ciklin e prodhimit te asfaltobetonit dhe humbet me lenden e ngurtesuar te asfaltit dhe pjeserisht depozitohet me thase e do te dergohet per menaxhim ne kompanite e asgjesimit, ose ne landfill te pershtatshem.

- Ndërtimi i linjës elektrike

Në varësi të llojit të pajisjeve dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrejtja e shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjëndje mjaft të mire dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Objekti i ushtrimit te aktivitetit dhe zyrat jane te pajisura me kasete të shpërndarjes së energjisë elektrike. Per mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike eshte parashikuar nje rrjet tokezimi ne zonen e rezervuareve dhe sisteme tokezimi te vecanta per çdo pajisje.

- Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brëndshme

Objekti lidhet me infrastrukturen e zones, me rrugen "Argjinatura" dhe rrugen hyrese per ne prone. Gjithashtu pergjate gjithë gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave.

Infrastruktura prane eshte e mire, me standartet bazike te saj. Gjithashtu objekti nuk perben problem per trafikun perqark zones, ne te cilin ndodhet. Aksi i rruges kryesore nga prane tij eshte i shtruar me asfalt. Ky shesh per nga madhesia e aktivitetit lejon qarkullimin e lire, hyrje – dalje si dhe manovrimet e automjeteve (kamionave dhe mjeteve te tjera ndihmese te aktivitetit), te cilat do t'i sherbejne ketij aktiviteti ne kushte te plota sigurie, si dhe mjetet e zjarrfikeseve ne rastet emergjente, te cilat mund te shfaqen ne kete aktivitet.



481329.353
4583945.691

481635.340
4583945.691



481329.353
4583751.091

481635.340
4583751.091

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH


Legjenda

- Ortofoto 2015 20 cm
- Shtresë Bazë
- Parcelat
- Ndërtesat
- Rendi 3 (Kufi Bashki)
- Rendi 2 (Kufi Qarku)
- Rendi 1 (Kufiri Tokësor)



Sqarim: Nuk disponojme fragment nga Studimi Urbanistik i Bashkise Kamez

Harta topografike e rajonit. Nomeklatura e Hartës në shkallën 1:10000 (K-34-88-D-c-1)



Koordinatat e objektit ne sistemin Gaus-Kruger te gjeneruara ne portalin asig.gov.al

Nr.	Koordinatat Y	Koordinatat X
1	4397945.28	4584742.72
2	4397907.92	4584697.96
3	4397991.75	4584617.14
4	4398023.19	4584652.53

e. PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- **INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;**
- **Veprimtarite e katranit dhe bitumit**

-ID 7.3. c. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi.

- **LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;**

Lendet e para për vendosjen në funksionim të instalimit janë materialet inerte, bitum, vajguri, telkodinak, sodë kaustike, uji, gaz, ndersa lendet ndihmëse janë energjia elektrike dhe karburanti për mjetet e transportit, etj.

- **BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI;**

Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	A1
Burimi i shkarkimit	
Përshkrimi	Nga procesi i prodhimit të asfaltobetonit
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	
Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m)	
Data e fillimit të shkarkimeve	

Emetimet në ajër vijnë vetëm nga prodhimi i asfaltobetonit, ndërsa prodhimi i emulsionit bituminoz nuk shoqërohet me shkarkime në ajër.

Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve (një faqe për çdo pikë të shkarkimeve)

Nr. Ref. i pikës së shkarkimit: (numri i referencës duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit)	Nuk ka shkarkime të Ujerave. Procesi teknologjik, nuk përfshin përdorimin e ujit.
Vendndodhja e pikës së shkarkimit rrjetin e kanalizimeve	Nuk ka shkarkime të Ujerave.
Koordinatat (për efekt të vlerësimit të ndikimit)	Nuk ka shkarkime të Ujerave.
Emri i kompanisë e cila menaxhon sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura	
A është sistemi i kanalizimeve i lidhur me një impiant trajtimi?	
Emri i mjedisit përfundimtar ujqor pritës të ujërave të ndotura nga rrjeti i kanalizimit (estuar, lumë ose mjedis tjetër ujqor pritës dhe ndikimi në të i cili duhet kontrolluar)	

Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

Burimi i shkarkimit	Nr. Ref. i pikës së shkarkimit	Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	Nr. Ref. i pajisjes që gjeneron ndotje akustike	Presioni akustik ¹ (dBA) duke ju referuar distancës	Periudha e shkarkimit
Zhurme nga elektromotorret e mikserit dhe transportiereve të	1		Elektromotore		Gjate proceseve të funksionimit

inerteve dhe te bitumit e asfaltit.					
-------------------------------------	--	--	--	--	--

- **KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES;**

Zona ku do te zhvillohet aktiviteti per prodhimin e asfaltbetonit, ndodhet ne Qarkun Tirane, bashkia Kamez, prane fshatit Çerkeze, (pasuria me nr. 343/4, zona kadastrale nr. 2066).

• **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE**

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise, e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i pajisjeve dhe makinerive te larjes/pastrimit te konteniereve. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme nga ky raport i ndikimeve në mjedis. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

- **Impakti ne mjedis i ketij impianti dhe menaxhimi i tij**

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin, te cilat lidhen me operimin e punes ne instalimin e prodhimit te asfaltobetonit, se bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre. Aspektet mjedisore me te rendesishme qe lidhen me instalimet e prodhimit te asfaltobetonit kane te bejne kryesisht me shkarkimet ne ajer, ujera dhe zhurma.

Shkarkime ne uje

Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera higjenosanitare te cilat shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Nga procesi i prodhimit te asfaltobetonit, nuk ka shkarkime te lengeta, pasi procesi teknologjik nuk perfshin ujin ne teresine e tij. Shkarkimet e vetme dhe shume te rendesishme jane vetem ato te gazta ne atmosfere.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer jane pika me e rendesishme e ndotjes dhe shkarkimeve ne mjedis te ketij aktiviteti. Ndotja me e madhe vjen nga aktiviteti i prodhimit te asfaltobetonit, i cili ka ne proces furre me lende djegese hidrokarbure (solar dhe gas). Per prodhimin e asfaltit, nevojitet qe bitumi te kete nje temperature qe varion 60-90°C, ne menyre qe te shnderrohet ne trajte te lengshme dhe te behet i mundur transportimi i tij per ne mikser dhe ne furren e shkrirjes, ku arrin temperatura rreth 170-180°C. Per te arritur kete temperature, sistemi ka nje kaldaje e cila ne rastin ne vleresim, funksionon me lende djegese Naftë e perpunuar. Ndersa furra e tharjes se materialit dhe e miksimit te inerteve me bitumin funksionon me lende djegese gas, duke qene se kerkon nje energji dhe nje temperature me te larte ne furre. Emetimet ne ajer vijne vetem nga prodhimi i asfaltobetonit, ndersa prodhimi i emulsionit bituminoz nuk shoqerohet me emetime ne ajer.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat që prodhohen në kantier janë të ndryshme. Ato mund të shkaktohen nga mjetet e transportit të rënde, nga mjetet e ngarkim-shkarkimit të materialit dhe procesit të impiantit të pordhimit të asfaltobetonit. Gjithashtu zhurma mund të shkaktohen edhe nga përdorimi i kompresoreve dhe i gjeneratorit në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike. Këto zhurma nuk janë të larta për punonjësit, megjithatë, në rast të shqetësimeve të mundshme, ata mund të përdorin kufje gjatë punës.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje të ngurta që prodhohen janë ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vlerësohet aktiviteti me mbetje të ngurta, paletat, plastmasi, metalet, etj., janë 100% të ricikluar dhe menaxhohen nga kompania që mbulon këto shërbime në zonë. Mbetjet e rëndësishme në këtë proces teknologjik, është vetëm pluhuri i kapur nga filtri, i cili në pjesën më të madhe të tij rifutet në ciklin e prodhimit të asfaltobetonit dhe humbet me lëndën e ngurtësuar të asfaltit dhe pjesërisht depozitohet me thasë e do të derigojë për menaxhim në kompanitë e asgjësimit, ose në landfill të përshtatshëm.

Ndikimi në tokë

Ky aktivitet nuk ndikon në mënyrë të drejtperdrejtë në tokë. Nuk ka shkarkime në tokë. Në mënyrë indirekte, shkarkimet në ajër, mund të shëndërrohen në elementë ndotës për tokën, por kjo në sasi tepër të moderuar.

Ndikimi në Biodiversitet

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e ndjeshme të zonave të mbrojtura me ligj, gjithashtu ky lloj i aktivitetit nuk ndikon në biodiversitet. Aktiviteti ndodhet në një zonë pa bimesë, pa ndonjë vlerë ekologjike, pasi ndodhet në afërsi të shtratit të lumit Terkuze dhe pranë zonave të urbanizuara.

Ndikimi në Mjedisin Social

Ndikimi i këtij aktiviteti në mjedisin social, është pozitiv përse i përket punësimit, shërbimit të mirëmbajtjes dhe rikonstruksionit të rrugëve të rajonit të Tiranës, etj. Për të shmangur katastrofat e rënies së zjarrit, megjithatë ato nuk ndodhin shpesh por edhe duke qenë të rralla ato përbejnë potencial dëmimi ekonomik, social, e mjedisor. Objekti nuk duhet të funksionojë në një zonë të rrezikuar nga përmbajtjet, të rrezikuar nga zjarret (siç janë pyjet pa akses rrugor), në kantier nuk duhet të ketë akses askush i paautorizuar dhe duhet të ketë siguri të ruajtjes fizike maksimale. Është shumë e rëndësishme të respektohen rregullat e sigurimit teknik në punë. Ndikimi në shëndetin e punonjësve apo të banorëve të zonës, është në varesë të nivelit të shkarkimeve në ajër. Duke qenë një instalim i ri, brenda të gjitha standardeve dhe me sistem filtrimi të shkarkimeve në ajër, vlerësohet të mos shqerohet me ndikime në shëndetin e popullatës. Përveç të tjerash, nisur edhe nga kapaciteti prodhues i instalimit, do të funksionojë pak orë në ditë dhe do të ketë ditë gjatë të cilave nuk do të funksionojë fare. Kështu, shkarkimet në mjedisin e zonës, bazuar në standartin e fabrikës, gjenden në mjedisin e zonës, si dhe orëve të punës, shkarkimet në ajër nuk vlerësohen me ndikime të rëndësishme.

Investitori, brenda gjashtë muajsh nga data e leshimit të lejes mjedisore, do të kryej matjen e shkarkimeve në ajër nga laborator të akredituar dhe rezultatet do të verë në dispozicion të institucioneve përkatëse dhe publikut të gjere të interesuar.

Sistemi i përballimit të emergjencave

Objekti i këtij raporti është aktiviteti i depozitimit dhe përdorimit të lendeve djegëse fosile të tilla si: Bitumi dhe Solari. Objekti ndodhet Qarkun Tiranë, Bashkia Kamez, pranë Fshatit Çerkeze.

Për mbrojtjen nga zjarri, subjekti ynë ka marrë të gjitha masat dhe mjetet e nevojshme në rast se në aktivitet bie zjarr. Në objekt janë instaluar bombula me shkumë për mbrojtjen nga zjarri. Përveç

bombulave me shkume, kemi instaluar edhe nje depozite per rezervuar uji ne raste te emergjencave te nevojshme. Bitumi eshte ne trajte te ngurte dhe veshtiresisht i djegshem, ndersa solari, eshte lehtesisht i djegshem keshtu qe nuk perben ndonje rrezik madhor. Persa i perkete instalimeve elektrike ato jane kryer te reja dhe nuk perbejne rrjet te amortizuar. Ne pikat e larta te objektit jane kryer tokezime dhe rrufeprites.

Masat mbrojtese dhe kushtet teknike qe duhet te zbatohen ne objektet e magazinimit me pakice te karburanteve.

Rreziku per renien e zjarrit ne objekt

Gjate funksionimit mund te sjelle rrezikshmeri per aksidente. Ne rast se do te kemi derdhje te lendeve si hidrokarbure nga automjetet e transportit duhet te merren masa per largimin e saj nga mjedisi si dhe duhet te vendosen tabela sinjalizuese per te shmangur aksidente rrugore gjate hyrjes dhe gjate daljes nga objekti.

Produktet e karburantit dhe temperaturat e ndezjes

Nxehtësia e mjaftueshme për të krijuar avullimin e karburanteve që mund të ndizen, quhet pika e ndezjes së Benzolit 40°C, Benzoli mund të avullojë madje edhe në 40°C. Gazoili 55°C. Gazoili avullon në temperature 55°C dhe më të lartë se kjo. Në kontakt me një lëndë ndezëse, nuk është karburanti ai që merr flakë, por gazi që lëshon. 1 litër karburant krijon 300 herë vëllim më të madh nga avullimi. Kur avullon 1 litër LPG, arrin në vëllimin 248 herë më të madh. Gjithashtu avujt e produkteve të karburantit dhe LPG-së, për shkak se janë më të rënda se ajri, nuk largohen nga terminali por qendrojnë aty dhe krijojnë mundësinë e një plasjeje apo djegieje. Avujt e karburantit dhe Gaz-it, janë më të rëndë se ajri, për këtë arsye në stacionet e magazinimit, gjithmonë gjendet avull karburanti dhe Gaz-i.

Në ambientet e terminaleve, në zonat ku avulli i karburantit është më i dendur, përdorimi apo ndodhja e një burimi nxehtësie apo zjarri, ndez avullin e karburantit. Për këtë arsye në mjediset e magazinimit nuk duhet të gjendet, asnjë burim shkëndije apo zjarri që mund të ndezë avullin e çliruar. Zjarri shkaktohet nga bashkimi i tre elementëve: Burim zjarri ose Nxehtësi, lënda djegëse dhe prania e Oksigjenit.

Benzoli, i cili mund të ndizet ose avullojë në temperature 40°C, është një produkt shume i rrezikshëm. Avulli i benzolit: sidomos në mot të qetë dhe pa erë, grumbullohet në pjeset me te aferta me sipërfaqen e tokës. Për këtë arsye mund te jete nje rrezik per zonat qe ndodhen shkëndija ose burime nxehtësie.

Elektro-Statika

Ngarkesa elektirke që shkaktohet nga fërkimi i dy trupave, quhet Elektro-Statike.

Shëmbulli më konkret që mund të jepet për eketro–statikën është rrufeja. Në jetën e përditshme, kur hapim derën e makinës, kur krehim flokët, kur perdorim nje veshtje sintetike, etj, krijohet fenomeni i elektrizimit sintetik.

Automjetet gjatë rrugës, para se të hyjnë në pikën e ruajtjes së karburantit, gjatë rrugës duke qenë në lëvizje fërkohen me ajrin dhe për këtë arsye krijojnë një elektrizim statik. Nëse automjeteve kur hyjnë në terminal, nuk u shkarkohet elekticiteti qe zoterojne, ne lendet e ndjeshme, kjo mund te jete nje rrezik.

Zjarret e Karburanteve

Zjarret e karburanteve klasifikohen ne tre lloje. Zjarret A, B dhe C.

Zjarret e lëndëve si benzol, gazoil, vajgur, alkol, klasifikohen në zjarret B. Lëngjet djegëse, krijojnë zjarre lëndësh. Pika bazë në fikjen e këtyre zjarreve, është mbytja e flakës. Lënda më efektive në fikjen e këtyre zjarreve, është shkuma dhe pluhurat. Në zjarret e krijuara nga benzoli dhe gazoili, nuk duhet te perdoret ujë. Uji ne kete rast, luan rol negativ.

Zjarret GLN, klasifikohen në zjarret e tipit C. Janë zjarre lëndësh djegëse të gazta. Gazet si, gazi natyral që përdoret në familje, hidrogjeni, GLN dhe metani janë lëndet djegëse të gazta. Lëndët me eficientë për shuarjen e tyre janë shkuma dhe pluhurat.

Shkaqet e rënies së zjarrit në objekt

- Cigare
- Elektro-Statika
- Celulari
- Ndriçimi dhe rrjeti elektrik i amortizuar
- Kryerja e saldimeve në afersi të depozitave
- Etj.

Bombulat për mbrojtjen nga zjarri

Për të qënë të sigurt se në një rast urgjent, bombula e fikësit të zjarrit me pluhur që ndodhet në aktivitet, duhet të jetë funksionale, duhet që të mirëmbahet dhe testohet herë pas here. Kontrollë periodike nga subjekti që kryen rimbushjen e tyre. Gazi dhe shkuma që ato përmbajnë kanë një afat skadence dhe duhet të rinovohen. Gjithashtu edhe akti teknik i kontrollit nga Reparti zjarrfikës do të rinovohet rregullisht sipas procedurave në fuqi.



Normat dhe cilesia e lejuar e tregimit të karburantit në vendin tone

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 147 dt. 21.03.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel"

1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm tregtimi i benzinës pa plumb, që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodet CN 27101141, 27101145, 27101149, 27101151 dhe 27101159 dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga data 1 Janar 2009, për përdorim në automjetet rrugore dhe gjeneratorët, do të lejohet vetëm tregtimi i lëndës djegëse diezel, që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101941, që plotëson kërkesat e Standartit Shqiptar S SH EN 590 ose standarte të tjera të barazvlefshme me të, me përjashtim të kushtit të lidhur me përmbajtjen e sqfurit, siç parashikohet në Aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Nga data 1 Janar 2009, përmbajtja e sqfurit në lëndën djegëse për motorret diezel nuk lejohet të kalojë 350 mg/kg.
4. Nga data 1 Janar 2011 përmbajtja e sqfurit në lëndën djegëse për motorret diezel nuk lejohet të kalojë 10 mg/kg.
5. Duke filluar nga 1 Janari 2009, të gjitha pikat e shitjes duhet të reklamojnë qartë dhe dukshëm për blerësit:
 - a. përputhjen e parametrave mjedisorë të benzinës me standartin shqiptar S SH EN 228 në fuqi ose standarte të tjera të barazvlefshme me të.
 - b. përmbajtjen maksimale të lejueshme të sqfurit si dhe përputhjen e parametrave mjedisorë të diezelit me standartin shqiptar S SH EN 590 ose standarte të tjera të barazvlefshme me të.
6. Testimi i çdo parametri do të bëhet sipas metodave të testimit si më poshtë:
 - a. për benzinën, sipas standartit shqiptar S SH EN 228, ose standarte të tjera të barazvlefshme me të.
 - b. për diezelin, sipas standartit shqiptar S SH EN 590, ose standarte të tjera të barazvlefshme me të.

- **TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME;**

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e prodhimit të asfaltbetonit dhe emulsionit bituminoz. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave dhe vaskes dekantuese. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku janë të instaluar pajisjet dhe makinerite.
Biodiversiteti	
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Mirembajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidanëve të rinj, përgjatë rrugës që ben të mundur hyrjen për në objekt.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve në ajër nga funksionimi i linjes së rikuperimit, magazinimit dhe transferimit të mbetjeve	Mirembajtja e linjes dhe reduktimi i shkarkimeve në ajër. Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës së prodhimit të betonit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
Sistemi i drenazhimit	
Sistemi i drenazhimit	Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe vaskes dekantuese ku shkarkohen ujerat e përdorura nga aktiviteti, përpara se të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zonës.
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve industriale dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.	Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre drejt operatoreve të licencuar.
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Ushtimi i operacioneve të prodhimit të asfaltbetonit dhe emulsionit bituminoz brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për

	mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve	Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

- ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR;

Shoqëria ALBAVIA Sh.p.k ushtron aktivitetin e prodhimit të asfaltobetonit dhe emulsionit bituminoz në një sipërfaqe prane 12000 m², e cila është e pozicionuar në Qarkun Tiranë, Bashkia Kamez, pranë fshatit Çerkeze (pasuria nr. 343/4, zona kadastrale nr. 2066).

- MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në objektin ku ushtrohet veprimtaria e "Impiant prodhimi betoni", mbrojtjen nga pluhurat, gazrat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor "Mbrojtjen e Mjedisit", reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, PM2.5, CO₂, NO_x, SO_x në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë efikente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti "ALBAVIA" Sh.p.k, me përfaqësues ligjor Z. Shkelqim Rakipaj ka hartuar "Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës", sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme

Çfarë	Masat	Kush i zbaton
Parandalim	<ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë magazinimit, transportimit dhe përdorimit të teknologjisë. - Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme. - Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik. - Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis. - Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës, si: doreza, këpucë me veshje gome, syze për mbrojtjen e syve, maska kundër gazeve dhe pluhurave, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen - Kapja dhe pastrimi i menjëhershëm në rast derdhesh të lubrifikantëve, si dhe grumbullimi i tyre në kontener (fuçia) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjësimit të tyre përfundimtar nga kompanit e nënkontraktuar. - Menaxhimi i integruar i mbetjeve. - Testimi paraprak i gjithë teknologjisë (instalimeve) dhe rrjetit 	Investitori, Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.

	<p>elektrik.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pastrimi periodik i vendit të pastrimit te aktiviteti dhe sheshin e parkimit te automjeteve/makinerive te transportit, pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike te larjes dhe të shiut. - Kolaudimi periodik i automjeteve. - Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë. 	
Kontroll	<ul style="list-style-type: none"> - Kontroll i automatizuar i të gjithë automjeteve, nëpërmjet programeve inxhinierike - Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe pajisjeve te punes. - Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e subjektit ku zhvillohet aktiviteti. - Vëzhgimi dhe kulaudimi i vazhdueshëm i të gjithë instalimeve dhe automjeteve/makinerive te pastrimit te mbetjeve. - Përdorimi eficienti i energjisë elektrike si dhe sigurimi i ambientit të objektit me ndriçimin e duhur për zhvillimin e aktivitetit. - Menaxhimi i integruar i mbetjeve ne zbatim te kushteve te kontrate se pastrimit - Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e subjektit. - Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash. - Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme. 	Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.
Ndërhyrje	<ul style="list-style-type: none"> - Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike - Mobilizimi i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit. - Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparatura nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti. - Zëvendësimi i menjehershëm të pjesëve të pajisjeve/aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme. - Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar. - Riparimi i menjehershëm i teknologjisë dhe automjeteve, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve. - Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore. - Reduktimi i sasisë së ujrave të përdorura për qëllime sanitare, si dhe në rastet e kontaminimit me mbetje të rrezikshme izolimi i tyre në kontenier të posaçëm dhe të izoluar hermetikisht. - Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për 	Personeli dhe organet Shtetërore të Specializuara.

	<p>operimin normal të punës në objekt.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njoftimi i menjehershëm i automjeteve dhe njërive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj). 	
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi të gjithë, zones, instalimeve, infrastrukturës dhe mjeteve të përshkuara më sipër. 	

Raportimi i masa të ndërmarra për programin e përmirësimit të operimit

Raportimi i masave që do të ndërmerren në objektin ku ndodhet impianti për prodhimin e asfalobetonit dhe emulsionit bituminoz, do të kryhet nga subjekti **“ALBAVIA” Sh.p.k** sipas një kalendari dhe regjistri të veçantë, i cili do të plotësohet nga drejtuesi teknik i punës në impiant dhe do të raportohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me miratimin e Përfaqësuesit Ligjor, Z. Shkelqim Rakipaj.

• Masa lehtësuese të tjera të kërkuara/ndërmarra

- Duhet të punohet sipas rregullores së kushteve teknike, nuk duhet të lejohen derdhje të karburanteve dhe lendeve të tjera djegëse në mjedisin e aktivitetit, pasi ndotin ambientin dhe mund të jenë burim aksidenti dhe shkaktojnë zjarre të pa dëshiruara dhe me tej mund të shkaktojnë edhe shperthime.
- Në sheshin e aktivitetit, nuk duhet të magazinohen materiale të rrezikshme si lende plasese, etj.
- Mjetet rrugore që qarkullojnë do të jenë konform normave të percaktuara dhe të testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik të Automjeteve dhe të pajisura me certifikatën e Vertetimit Teknik nga Inspektoriati Qendror Teknik.
- Përsëri të përkete pluhurave LNP tek punonjësit në kantier që janë të ekspozuar, të përdoren maskat me filter ose syze.
- Përsëri të përkete zhurmave të makinerive, do të përdoren kufje për të mbrojtur shqisat e degjimit.
- Do të merren të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.
- Nuk do të lejohet shkarkimi i pa kontrolluar i lendeve djegëse në mjedisin e kantierit.
- Ambienti do të mbahet pastër dhe nuk do të ketë asnjë derdhje të lendeve të djegëshme në sheshin e kantierit, është shtruar me beton sheshi i ngarkimit dhe shkarkimit të mjeteve në mënyrë që të shmangen derdhjet e lendeve të lengshme në mjedisin e zones.
- Depozitat e lendeve djegëse do të ruhen në kushte optimale dhe të mbuluara me tende për mbrojtjen nga rrezatimi dhe nxehtësia diellore.
- Janë ndertuar rrufepritesit në të katër qoshet e sheshit të zhvillimit të aktivitetit.
- Për të shmangur efektet e djegies dhe të shperthimit, subjekti është pajisur me depozite uji dhe sistem tepër efektiv dhe të disponueshëm për të reduktuar demet në raste të tilla të fenomeneve. Objekti nuk është i rrezikuar nga permbytjet, erozioni, zjarri (sik janë pyjet), nuk ka akses askush i paautorizuar dhe ka siguri fizike maksimale.
- Në objektin e automjeteve zjarrefikëse kanë akses të plote rrugor.
- Është siguruar roje 24 orë dhe objekti ruhet nën kushte të rrepta sigurie.
- Nuk do të kryhet asnjë rikonstruksion apo riparim i instalimit, pa mbikqyrjen e drejtuesit teknik dhe pa boshatisjen e depozitave të lendeve djegëse.
- Në rast të shkarkimeve mbi normat e lejuara, subjekti ynë ka për detyrë të kryejë investime për reduktimin e gazeve që shkarkohen në mjedis, duke aplikuar filtra ose sisteme të reduktimit të gazeve.
- Lenda djegëse është e cilesisë së miratuar me ligj, sipas tabelës së mëposhtme:

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 147 dt. 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel”

Aneksi 2

Parametrat e lejuar mjedisorë për cilësinë e lëndës diegëse diezel

Parametrat	Njesia	Limitet	
		Minimum	Maksimum
Numri i Cetanit		51.0	
Densiteti ne 15°C	Kg/m ³	--	845
Pika e distilimit 95%	°C	--	360
Hidrokarbure policiklike aromatike	%m/m	--	11
Permbajtja e squfurit	mg/kg	--	350 nga 01.01.2009 – 1.12.2010; 10 nga 01.01.2011
Mbeturina karboni (mbi 10% mbeturina distilimi)	%(m/m)	--	0.30
Permbajtje hiri	%(m/m)	--	0.01
Ndotja totale	mg/kg	--	24

Respektimi i normave te shkarkimeve ne ajer sipas VKm 435, date 12.09.2002 “Per normat e shkarkimeve ne ajer”

Norma shkarkimesh [mg/ m ³]per					Permbajtja referente e oksigjenit O ₂ [%]	Kushte referimi
Substanca te ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO ₂	Okside azoti si NO ₂	Oksid karboni CO	te tjera		
1	2	3	4	5	6	7
Perzierjet e veshura me asfalt dhe impiantet e perzierjes se asfalteve						
20	¹⁰⁾			17 ¹¹⁾	A	
a) Shkrirja e lendeve te para ne furrat me kupole me kapacitet shkrirje < ose 10 t/ore						
100/75		¹²⁾			C	

Aspektet mjedisore dhe teknikat me te mira te disponueshme

Per kete instalim, aspektet mjedisore negative konsistojne ne shkarkimet ne ajer te gazeve te demshem dhe te pluhurit fluturues te hirit. Keto gaze gjate punes shkaktohen nga djegia e lendes djegese Solar dhe Gazit natyror. Keto lende djegese blihen ne tregun vendas dhe jane te cilesise qe tregtohet ne treg aktualisht, pra te kontrolluara nga institucionet perkatese. Keto gaze gjate djegies jane te demshme per shendetin dhe per mjedisin fizik e biologjik ne pergjithesi. Persa i perkete shkarkimeve ne toke dhe ne uje, nuk kemi te tilla. Aspektet pozitive ose kushtet e favorshme te funksionimit te ketij instalimi konsistojne ne rritjen e punesimit dhe te ardhurat ne zone. Kontribut ne mirembajtjen dhe riparimin e rrugeve te rajonit. Pozicioni gjeografik dhe distancat nga qendrat e banuara, si edhe cilesia e ajrit, jane kushte te favorshme per zhvillimin e aktivitetit. Per kete aktivitet, deri me tani nuk kemi asnje shqetesim nga banoret. Oret e pakta te punes ne nje vit ndikojne pozitivisht qe ky instalim nuk kontribon ne rritjen e ndjeshme te dioksidit te karbonit dhe gazeve te tjera “Greenhouses” ne atomsfere.

Ky instalim eshte prodhim i viteve te fundit, me teknologji te reja, perfshire edhe sistemi i filtrimit qe ne prodhimin fillestar te makinerise. Nje sistem i tille eshte i konvertueshem edhe per keto lloj impiantesh,

por duke pasur parasysh kostot e blerjes e te instalimit e pershtatjes, si dhe oret e punes ne nje vit, per kete impiant eshte pare e arsyeshme qe te funksionojne ne gjendjen ekzistuese dhe ne rast te nevojës per prodhim me te gjere, te pershtatet nje sistem reduktimi te gazeve, sic eshte sprucimi me uje per reduktimin e blozes, ose instalimi i nje sistemi filtrimi. Gjate raportimit te procesit te vetmonitorimit, duke u bazuar edhe ne analizat qe do te kryhen, do te merren edhe masat e nevojshme per reduktimin e shkarkimeve.

- **Kërkesa shëndetësore dhe mjedisore gjatë fazës ushtruese të veprimtarisë**

Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit nga subjekti “ALBAVIA” Sh.p.k ne fushen e prodhimit te asfaltobetonit dhe emulsionit bituminoz, do të ketë parasysh dhe të respektojë rigozorisht kërkesat e Rregullores Nr. 1, datë 15.03.2006 “Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis”, ku investitori do të marrë masa kryesore sic janë:

- Subjekti do të zbatojë kërkesat e lejes mjedisore si dhe normat e standartet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndikimet negative të veprimtarisë,
- Subjekti do të sigurojë zbatimin e masave që parandalojnë ndotjen e mjedisit dhe shkarkimet mbi normën e lejuar për zhurmat, ajrin, për ujin dhe për tokën, si dhe respektimin e kërkesave dhe të kushteve të Lejes Mjedisore të Tipit B.
- Menaxhimin e integruar te mbetjeve ne perputhje me kushtet e kontratave te punimeve civile dhe parimet e mbrojtjes se mjedisit.
- Për t’u mbrojtur nga zjarri i mundshëm që mund të bjerë në objekt do të vendosen shuars dhe hidrantë për fikjen e zjarrit në vende të dukshme ne ambientin ku zhvillohet veprimtaria ne fushen e menaxhimit te mbetjeve urbane.
- Për uljen e niveleve të zhurmave: Duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, të përcaktuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetsisë nr. 8, dt 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.

- **Masa per sigurimin teknik dhe mbrojtja ne pune**

Aktiviteti qe zhvillon subjekti “ALBAVIA” Sh.p.k praktikisht nuk perben rrezik per stafin (punonjesit) e tij, per arsye se investimet jane te koheve te fundit, me nje instalimi/pajisje te reja e moderne, i gjithë procesi i punes eshte i automatizuar ç’ ka e rrit sigurine e instalimeve/makinerive.

Mjetet e pastrimit te mbetjeve (mbetje jo te rrezikshme urbane) jane te certifikuara dhe nder me bashkekohoret ku pjesa me e madhe e proceseve jane te automatizuara duke shmangur keshtu nderhyrjen e punonjesve dhe te punuarit prane tyre, per veç te tjerash shoqeria ka disa rregulla strikte te cilat zbatohen me rigozoritet.

- **Detyrimet e punedhënesit:** Punedhënesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:
 1. Procesin e operacioneve ne teresi dhe te punes ne secilin prej instalimeve ku punon.
 2. Pajisjet dhe makinerite qe perdoren ne objekt per aktivitetin e prodhimit te betonit.
 3. Shkaqet e aksidenteve dhe masat dhe per menjanimin e tyre.
 4. Rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, aktet ligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikasteret qe lidhen me to.
 5. Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen sipermarresi si individ per mbrojtjen e vetes dhe punonjesve te tjere.
 6. Rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik ne impiante dhe sheshin e punes, per t’u mbrojtur nga makinerite, rrymes elektrike, shkarkesat atmosferike, etj.

7. Ndhimen e pare shendetesore.
8. Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentohet sipas formalitetit te percaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.
9. Ndalohet riparimi i avarive dhe punime te tjera kur makinerite jane ne levizje/procese pune.
10. Para se te fillohet nga puna behet kontrolli i frontit te punes, gjendja teknike e makinerive/pajisjeve etj.

Detyrimet e punemarresit: Detyrimet kryesore jane:

1. Te njoh rregulloren e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punes dhe t'i zbatoje ato ne pune.
2. Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve per çdo proces pune.
3. Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.
4. Kur konstaton shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare te marre masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjithë punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik/perfaqesuesin ligjor te shoqerise.
5. Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si: kapele, doreza, maskat e mbrojtjes nga pluhuri, gazrat dhe tapa veshi per zhurmat, uniforme te vecanta etj.
6. Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.

- **MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor pastrim, larje te konteniereve është që të sigurojë të dhëna, nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku jane instaluar impianti per pastrim, larje te konteniereve dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Plani i Monitorimeve Mjedisore

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve urbane, menaxhimit të mbetjeve, zhurmave etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencorë për të përket vërtetimit, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vërtetuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesorë të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjedisit ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e investitorit për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të ligjit "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë", kreu III, pika 10.

Plani i monitorimit mjedisor është i inkorporuar në projekt dhe përfshin inspektime dhe raportime rutinë. Më poshtë do të paraqesim disa monitorime që do të realizohen për treguesit e trysnisë në mjedis që janë detyrë e investitorit ku ai do të bashkëpunoj me instancat përkatëse.

Monitorimi i cilësisë së ujit:

Monitorimi gjatë operimit të aktivitetit, duhet bërë në zonat që ka vendosur supervizori. Monitorimi fillestar i cilësisë së ujit rekomandohet në zonat me burimet më të mëdha të ndotjes potenciale të ujit. Rekomandohet matja e grimcave në suspencë (MES), kërkesa biologjike për oksigjen NBO5, konduktiviteti dhe coliformet fekale. Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet nga specialistët e lejeve të mjedisit dhe do të kontrollohen inspektorët e mjedisit (supervizori) gjatë operimit të punës.

Monitorimi i cilësisë së ajrit:

Monitorimi i cilësisë së ajrit duhet bërë në zonat që ka vendosur supervizori, brenda zonës që do të ushtrohet ndikimi.

Monitorimi me aparate për ndotësit e ajrit, përveç grimcave totale në suspencë nuk konsiderohet e justifikueshme në kushtet ekzistuese të ambientit, sepse nuk ka impakte të rëndësishme në këtë projekt.

Masat e sigurisë për monitorim shtesë me kërkesë të supervizorit do të specifikohen nëse hasen rrethana të paparashikuara.

Monitorimi i zhurmave:

Operimi i pajisjeve dhe i makinerive gjatë gjithë procesit, kërkon të monitorohet niveli i zhurmave, i cili nuk duhet të kalojë nivelet e caktuara. Ndotja akustike në mjediset e punës është parësore për shoqërinë, sepse sjell uljen e produktivitetit të punonjësve dhe rritje të stresit.

Investitori do të realizojë monitorim me aparaturë, një herë përpara fillimit të punimeve, për të vendosur drejtimet kryesore të impakteve që do të maten. Monitorimi fillestar i zhurmave do të kërket vetëm aty ku kohëzgjatja e potencialeve të ndikimeve dhe receptorëve e ndjeshëm të justifikojë këtë monitorim.

Programi i monitorimit do të përdoret për të verifikuar që të gjitha ndotjet e mundshme që do t'i shkaktohen mjedisit nga funksionimi në këtë aktivitet. Investitori do të monitorojë vetëm pikat, për të cilat ai ndikon mbi to (pikat do të përcaktohen nga organet kompetente), si dhe i dërgojnë këto të dhëna në Agjencinë Kombetare të Mjedisit të paktën dy herë në vite, sipas legjislacionit perkates. Këto të dhëna do të vihen në dispozicion të inspektorëve të mjedisit gjatë inspektimit të tyre.

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm, sipas kushteve të shfrytëzimit të krijuar gjatë aktivitetit, do të çojë përfundimisht në përfitimin e pamjeve të parashikuar në projekt me sipërfaqe të sistemuar dhe të gjelbëruar, si dhe me një ambient shërbimi të mire menaxhuar duke menduar për brezat pasardhës.

f. KONSULTIMET NDERKUFITARE

Zona ku zhvillohet do të zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojë t'i nenshtrohet procesit të konsultimit nderkufitar.

g. AUTORITETI VENDIMARRES PER DHENIEN E AKTIT TE MIRATIMIT TE LEJES SE MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QE NDIQEN.

Autoriteti miratues është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos për miratimin apo refuzimin e aplikimit për t'u pajisur me leje mjedisit të tipi B, me propozim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacionin e paraqitur nepermjet Qendres Kombetare te Biznesit.

Afati për marrjen në shqyrtim të aplikimit për pajisjen me leje mjedisit të tipit B është 40 ditë pune.

h. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TE DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NE FORME ELEKTRONIKE, BRENTA 20 DITE NGA DATA E NJOFTIMIT.

Faqja zyrtare e Agjencise Kombetare te Mjedisit: akm.gov.al